



**ANALIZA THEMELORE**  
E PUNËS SË  
**KËSHILLIT GJYQËSOR**  
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

INSTITUTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT - IDNJ

Shkup, 2016

**Editor**

Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shkup

**Autorë**

Margarita Caca Nikollovska

Vera Koco

Lubin Aleksijevski

**Redaktore**

Kristina Doda

Jelena Kadrikj

**Lekturoi**

Tatjana Stojanovska

**Përktheu**

Blerina Starova Zlatku

Irena Kacarski Kimovaa

**PËRMBAJTJA**

Hyrje.....	4
Struktura organizative dhe rëndësia e pushtetit gjyqësor.....	6
Pavarësia dhe paanshmëria e pushtetit gjyqësor .....	7
Këshilli Gjyqësor i RM .....	9
Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësive së Gjyqtarit.....	12
Kompetencat e Këshillit Gjyqësor të RM dhe të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve.....	13
Procedura e zgjedhjes së gjyqtarëve .....	15
Përcaktimi i numrit të nevojshëm të gjyqtarëve në gjykatat e RM.....	15
Kushtet për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve (të përgjithshme dhe të veçanta) .....	19
Ngritja e procedurës disiplinore kundër gjyqtarëve dhe procedurës për shkarkimin e gjyqtarëve.....	23
Rishpërndarja e gjyqtarëve.....	26
Puna e Këshillit Gjyqësor të RM dhe Këshillit të Fakteve .....	29
Transparenca e punës së KGJRM .....	30
Transparenca e punës së Këshillit të Fakteve.....	31
Llogaridhënia dhe përgjegjësia e Këshillit Gjyqësor të RM.....	31
Llogaridhënia dhe përgjegjësia e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve .....	33
Analiza e pyetësorëve të dërguar deri te publiku profesionist (avokatë) .....	34
Analiza e pyetësorëve të dërguar deri te publiku i gjerë .....	38
Fokus grupi .....	41
Konkluzion.....	42



British Embassy  
Skopje

Ambasada Britanike Shkup mbështeti përgatitjen e këtij publikimi, brenda projektit "Monitorimi i rritur publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM". Përmbajtja e këtij botimi nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës Britanike.

## HYRJE

Kjo analizë themelore e punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë u hartua në kuadër të Projektit “Monitorimi i rritur publik mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM” të realizuar nga Instituti për të Drejtat e Njeriut me mbështetje të Ambasadës së Britanisë në Shkup. Analiza ofron një pasqyrë të gjendjes aktuale lidhur me punën e Këshillit Gjyqësor të RM (në tekstin në vijim KGJRM).

E drejta e qytetarit, që ta gjykojë një gjykatës i pavarur dhe i paanshëm është postulati themelor i pushtetit gjyqësor. Pavarësia dhe paanshmëria janë vlera të pushtetit gjyqësor të cilat garantohen me Kushtetutën e RM, me ligjet e RM dhe me dokumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga RM.


Edhe pse teksti në përgjithësi ka të bëjë me punën e KGJRM, për shkak të formimit të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit (në tekstin në vijim Këshilli i Fakteve)<sup>1</sup> dhe ndërlidhjes së tij me punën e KGJRM, gjatë kohës së përpilimit të tekstit ishte e domosdoshme të prezantohet një pasqyrë e shkurtër e kompetencave dhe gjendjes aktuale të punës së këtij organi.

Analiza e elaboron gjendjen aktuale të këtyre dy organeve, e që pastaj do të shfrytëzohet për përcaktimin e drejtimeve të veprimit IDNJ, si dhe për matjen e ndryshimeve që mund të ndodhin. Sa i përket përcaktimit të gjendjes, u analizua legjislativi me të cilin rregullohet pushteti gjyqësor, kompetencat e KGJRM dhe të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve, procedurat, kushtet dhe kriteret e zgjedhjes së gjyqtarëve, procedura e shkarkimit të gjyqtarëve dhe rishpërndarja e tyre, si dhe transparenca dhe efikasiteti momental i punës së këtyre dy organeve. Në lidhje me punën e tyre konkrete në praktikë, informacionet i kemi siguruar nga monitorimi i vazhdueshëm i mbledhjeve të KGJRM nga ana e Institutit për të Drejtat e Njeriut.

Sa i përket njohurive të publikut, për ekzistimin dhe punën e KGJRM dhe të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve, informacionet janë siguruar përmes sondazhit të opinionit publik. U zbatua anketa on-line e publikut profesionist – avokatëve ndërsa përgjigjet e fituara nga avokatët lidhur me mendimin dhe përvojën e tyre, sa i përket punës së KGJRM dhe Këshillit për Përcaktimin e Fakteve, janë prezantuar në këtë analizë. Në mënyrë që të përcaktohet perceptimi dhe njohuria për punën e Këshillit Gjyqësor të RM nga ana e publikut jo-profesionist, u realizua edhe një debat në formë të fokus grupit, ndërkaq rezultatet janë prezantuar në këtë analizë. Këto përgjigje shërbejnë që të përcaktohet gjendja aktuale lidhur me perceptimin e këtyre organeve nga publiku i gjerë dhe ai profesionist, me qëllim që në të ardhmen të maten ndryshimet e mundshme.

## STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE RËNDËSIA E PUSHTETIT GJYQËSOR

Pluralizmi politik dhe ndarja e pushtetit janë baza për ndarjen e shtetit nga partitë politike e që trajtohet si nevojë prioritare në mënyrë që pastaj të realizohet ndarja e tre pushteteve gjatë zbatimit të pushteti shtetëror. Kjo pavarësi duhet të perceptohet përmes sistemit të ushtrimit të pavarur të funksioneve të çdo pushteti veç e veç në kuadër të kompetencave të tyre, me ç’rast nevojitet një bashkëpunim i caktuar, por pa ndërhyrje.



Përveç Kushtetutës së RM e cila e rregullon pavarësinë e gjyqësorit, ekzistojnë edhe ligje përmes zbatimit të të cilëve duhet të realizohet pavarësia. Bëhet fjalë për Ligjin për gjykata<sup>2</sup>, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RM<sup>3</sup> dhe Ligjin për Këshillin për Përcaktimin e

*Sovraniteti i RM-së u takon qytetarëve dhe ai edhe pse buron nga qytetarët, pushteti realizohet përmes përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë demokratike, të cilët e kanë për detyrë t'i respektojnë dhe zbatojnë tërësisht të gjitha vlerat themelore të sundimit të së drejtës, respektimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e institucioneve demokratike të cilat si parime janë parashikuar në dokumentet vendore dhe ndërkombëtare.*

<sup>1</sup> Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, “Gazeta Zyrtare e RM” nr. 20/2015.

<sup>2</sup> Ligji për gjykatat, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/06 35/08, U. nr. 256/07, U. nr. 74/08,150/10, U. Nr. 12/.

<sup>3</sup> Ligji për Këshillin Gjyqësor të RM. “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/06, 150/10, 100/11 dhe 15.

Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit<sup>4</sup>. Aktet nënligjore si rregulloret e punës dhe rregulloret e këtyre organeve janë mekanizma plotësues që e lehtësojnë dhe mundësojnë pavarësinë e gjyqësorit në praktikë.

## PAVARËSIA DHE PAANSHMËRIA E PUSHTETIT GJYQËSOR

Pavarësia e gjyqësorit mund të garantohet nëse korniza ligjore, brenda të cilës gjyqtarët i ushtrojnë funksionet e tyre, mundëson numër të mjaftueshëm të mekanizmave mbrojtës, kundër tentativave që të ndikohet mbi gjykatësit. Megjithatë, garancia e sigurimit të pavarësisë dhe funksionimit të mekanizmave për sigurimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, para së gjithash, varet nga respektimi i detyrimit të pushteteve të tjera që ta respektojnë pavarësinë në praktikë.

Realizimi i pavarësisë së gjyqësorit, i cili është element i rëndësishëm i pushtetit gjyqësor, fillimisht realizohet përmes përzgjedhjes së gjyqtarëve të cilët e ushtrojnë funksionin e gjyqtarit. Zgjedhja e gjyqtarëve duhet të realizohet përmes mekanizmave të cilët në praktikë do ta garantojnë pavarësinë.

*Në përputhje me Nenin 98, pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat të cilat janë të pavarura dhe të mëvetësishme. Nenet 98, 99 dhe 100 duke i përfshirë edhe amendamentet e këtyre neneve nga Kushtetuta, parashikojnë mekanizma mbrojtës për pavarësinë e gjyqtarëve, siç është mandati i pakufizuar (deri në pensionim), ndërprerja e funksionit të gjyqtarit në kushte të parashikuara me Kushtetutë, shkarkimi i gjyqtarit i parashikuar me Kushtetutë sipas kushteve të përcaktuara me ligj, gëzimi i imunitetit dhe mbrojtja nga transferimi kundër vullnetit të gjyqtarëve.*

Pavarësia e gjyqësorit nuk përcaktohet vetëm me ligje të cilët e rregullojnë këtë çështje, por ajo është edhe rezultat i realizimit të pavarësisë në praktikë. Pavarësia e gjyqësorit konsiderohet si bazë për sundimin e së drejtës. Parimet themelore lidhur me gjyqësorin të Kombeve të Bashkuara<sup>5</sup> dhe Kartës Evropiane të Statusit të Gjyqtarëve,<sup>6</sup> e theksojnë

4 Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 20/2015.

5 Parime themelore për pavarësinë e gjyqësorit, të miratuara nga ana e Kongresit të Shtatë të Kombeve të Bashkuara për parandalimin e krimit dhe trajtimin e të dënuarve, të mbajtur në Milano nga data 26 gusht deri në datë 6 shtator me miratimin e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme 40/32 nga data 29 nëntor 1985 dhe 40/146 nga data 13 dhjetor 1985.

6 Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve Strasburg, 8 - 10 Korrik 1998.

### ÇKA DO TË THOTË PAVARËSIA E PUSHTIT GJYQËSOR?

Edhe pse nuk ekziston një përkufizim përgjithësisht i pranuar, pavarësia fillimisht do të thotë pavarësi e gjyqtarit nga palët në vet procesin e gjykimit dhe pavarësi nga pushtetet e tjera.

Në këtë kontekst, garancia për pavarësi është zgjedhja e gjyqtarëve të cilët i plotësojnë kushtet e pavarësisë, **paanshmërisë, integritetit, barazisë, profesionalizmit, kompetencës, zellshmërisë, përgjegjshmërisë, modestisë, sjelljes e cila imponon besim gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, si dhe kohëzgjatja e mandatit.**

rëndësinë e pavarësisë së gjyqësorit përmes përcaktimit eksplicit të elementeve thelbësore të një gjyqësori të pavarur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut pavarësinë e një gjykate, mes tjerash, e vlerëson edhe përmes vlerësimit të mënyrës së zgjedhjes dhe caktimit të anëtarëve të saj, përkatësisht gjyqtarëve.

Në Rekomandimin R 94/12 të Këshillit të Evropës lidhur me pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve<sup>7</sup> theksohet si vijon::

### Shkalla e pavarësisë së gjyqësorit para së gjithash varet nga dy faktorë:

- i pari, mënyra se si gjyqtarët mbrohen nga ndikimet e personave të tretë fizikë ose juridikë, dhe
- i dyti, shkalla në të cilën gjyqtarët mendojnë, veprojnë dhe vendosin në mënyrë të pavarur, në bazë të fakteve dhe zbatimit konsekuent të ligjit.

*"Të gjitha vendimet, sa i përket karrierës profesionale të gjyqtarëve, duhet të bazohen në kriteret objektive, ndërsa zgjedhja dhe avancimi i gjyqtarëve duhet të bazohet në cilësitë e tyre, duke i pasur parasysh kualifikimet e tyre, integritetin, aftësitë dhe efikasitetin në punë. Organi i cili i merr vendimet lidhur me zgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve, duhet të jetë i pavarur nga pushteti dhe administrata shtetërore. Me qëllim që të mbrohet pavarësia e tij, duhet doemos të ekzistojnë rregulla përmes të cilave do të sigurohet që zgjedhjen e anëtarëve të tij – gjyqtarëve ta kryej vet gjyqësori, ndërsa pastaj ky organ të miratojë vendime për punën e vet dhe për rregullat procedurale".*

7 Rec (94) 12, 13/10/1994 për pavarësi, efikasitetin dhe për rolin e gjyqtarëve, Komiteti i Ministrave, Këshilli i Evropës

Në Opinionin 10 të Këshillit Konsulent të Gjyqtarëve Evropian<sup>8</sup> rekomandohen këshilla gjyqësore me përbërje mikse nga gjyqtarë dhe nga persona të cilët nuk janë gjyqtarë, ta përfaqësojnë pavarësinë e pushtetit gjyqësor në mënyrë që gjyqtarëve t'u mundësohet që funksionin e tyre të gjyqtarit ta ushtrojnë pa kurrfarë kontrolli nga ana e përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv ose ligjvënës të cilët janë anëtarë të Këshillit.

## KËSHILLI GJYQËSOR I RM

**Në përputhje me Kushtetutën e RM, Këshilli Gjyqësor është organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i gjyqësorit i cili e siguron dhe garanton pavarësinë dhe mëvetësinë të pushtetit gjyqësor, përmes ushtrimit të funksioneve të veta konform Kushtetutës dhe ligjeve.**

Ky përkufizim proklamon se Këshilli Gjyqësor ka status të organit të pavarur dhe të mëvetësishëm të gjyqësorit, më saktësisht organ me integritet të plotë gjatë ushtrimit të funksioneve të veta. Gjatë realizimit të funksioneve dhe kompetencave të veta, Këshilli Gjyqësor është i pavarur dhe i mëvetësishëm nga organet e pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv dhe, gjithashtu edhe nga cilido qoftë institucion tjetër, organizatë ose nga ndikimet politike dhe partiake.

Këshilli Gjyqësor si organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i gjyqësorit nuk është organ i cili është jashtë rendit juridiko-kushtetues dhe për të njëjtin vlejnjë të gjitha parimet e sundimit të së drejtës, mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe ndarja e pushtetit në atë ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor por edhe një organ i cili është balanc i të tre pushteteve të shoqërisë.

Për këtë, Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është konstituuar si një organ i pavarur dhe i mëvetësishëm i gjyqësorit, megjithatë në përbërjen e tij bëjnë pjesë edhe përfaqësuesit e dy pushteteve të tjera – ligjvënës dhe ekzekutiv, krahas përfaqësuesve të pushtetit gjyqësor.

Këshilli Gjyqësor si organ i pavarur dhe i mëvetësishëm gjyqësor që të mund ta sigurojë dhe garantojë pavarësinë dhe mëvetësinë e pushtetit gjyqësor duhet ta posedojë edhe atributin e profesionalizmit të lartë dhe integritetit të anëtarëve të cilët përfshihen

në përbërjen e tij si ata të cilët zgjidhen nga radhët e gjyqtarëve, ashtu edhe ata të cilët zgjidhen nga radhët e juristëve të shquar.

### **Këshilli Gjyqësor përbëhet nga 15 anëtarë::**

- sipas funksionit anëtarë të Këshillit janë Kryetari i Gjykatës Supreme i Republikës së Maqedonisë dhe Ministri i Drejtësisë;
- tetë anëtarë të Këshillit i zgjedhin gjyqtarët nga radhët e tyre. Tre nga anëtarët e zgjedhur janë pjesëtarë të bashkësive të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë, me ç'rast do të respektohet përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i qytetarëve të cilët u përkasin të gjitha bashkësive;
- tre anëtarë të Këshillit i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u përkasin bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë;
- dy anëtarë të Këshillit i propozon Presidenti i Republikës së Maqedonisë, ndërsa zgjedhjen e bën Kuvendi i Republikës së Maqedonisë prej të cilëve njëri është pjesëtar i bashkësive të cilat nuk janë shumicë në RM.

<sup>8</sup> Këshilli Konsulent i Gjyqtarëve Evropian - KKGJE (CCJE) Opinioni nr. 10 (2007) i Këshillit Konsulent të Gjyqtarëve Evropian (KKGJE) dedikuar Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me çështjen e Këshillit Gjyqësor në shërbim të shoqërisë. Ky Opinion është miratuar nga KKGJE në takimin e 8-të të tij (Strasburg, nga data 21 deri në datë 23 Nëntor 2007).

### Kushtet ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të RM:

KUSHTET PËR ZGJEDHJEN e anëtarit nga radhët e gjyqtarëve	KUSHTET PËR ZGJEDHJEN e anëtarit nga radhët e juristëve të shquar (sipas propozimit të Kuvendit dhe sipas propozimit të Presidentit të RM)
<ul style="list-style-type: none"> <li>● më së paku <b>pesë vjet stazh të gjyqtarit</b>;</li> <li>● të ketë <b>nota më të larta pozitive</b> në tre vitet e fundit gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të dhëna nga Këshilli;</li> <li>● <b>të gëzojë autoritet, të posedojë integritet</b> për ushtrimin e funksionit anëtar i Këshillit dhe <b>të posedojë aftësi sociale për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit</b>, për çka realizohen teste të integritetit dhe teste psikologjike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● të jetë <b>shtetas</b> i Republikës së Maqedonisë;</li> <li>● <b>jurist i diplomuar me më së paku 15 vjet përvojë pune</b> në profesionin juridik me provim të dhënë të jurisprudencës i cili gjatë ushtrimit të profesionit juridik është shquar me punë shkencore ose profesionale ose me veprimin e tij personal dhe</li> <li>● <b>të gëzojë autoritet, të posedojë integritet për ushtrimin e funksionit anëtar i Këshillit dhe të posedojë aftësi sociale për ushtrimin e funksionit anëtar</b> i Këshillit, për çka realizohen teste të integritetit dhe teste psikologjike.</li> </ul>

Më së paku pesë vjet stazh të gjyqtarit me nota më të larta pozitive në tre vitet e fundit gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit, nuk është indikator i mjaftueshëm për përvojën e tyre profesionale. Përvojë pune prej 15 vitesh është parashikuar për anëtarët e tjerë nga radhët e juristëve të shquar, përveç kushteve të tjera.<sup>9</sup>

Mandati i anëtarëve të zgjedhur të Këshillit zgjatë gjashtë vjet me të drejtë për edhe një rizgjedhje, megjithatë Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrit të Drejtësisë me ndërprerjen e funksionit u ndërpritet edhe mandati në Këshillin Gjyqësor.

9 Neni 11 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM.

## KËSHILLI PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE DHE NGRITJEN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË SË GJYQTARIT

Në sistemin e jurisprudencës së RM, përveç Këshillit Gjyqësor ekziston edhe Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit i cili u themelua pas miratimit të Ligjit me emërtimin e njëjtë në vitin 2015.<sup>10</sup>

### Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit zbatohet në mënyrën me të cilën zgjidhen:

#### 3 anëtarë nga radhët e gjyqtarëve të pensionuar

- Me stazh të pandërprerë të gjyqtarit prej më së paku 15 vjet
- Me rezultate të theksuara gjatë punës së tij
- Të cilët gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të gjyqtarit nuk kanë pasur sanksione disiplinore.

#### 3 anëtarë nga radhët e prokurorëve publikë të pensionuar

- Me stazh të pandërprerë të prokurorit prej më së paku 15 vjet
- Me rezultate të theksuara gjatë punës së tij
- Të cilët gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të prokurorit nuk kanë pasur sanksione disiplinore

#### 2 anëtarë nga radhët e profesorëve universitarë të pensionuar të Fakultetit Juridik në universitetet e Republikës së Maqedonisë

- Me stazh të pandërprerë universitar prej më së paku 15 vjet
- Me rezultate të theksuara dhe punime të publikuara shkencore gjatë punës së tij

#### 1 член од редот на пензионираниите адвокати

- Me stazh të pandërprerë të avokatisë prej më së paku 15 vjet, me rezultate të theksuara gjatë punës së tij dhe i cili gjatë kohës së ushtrimit të funksionit të avokatit nuk ka pasur sanksione disiplinore.

10 Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 20 nga data 12.02.2015.

## Kompetencat e Këshillit Gjyqësor të RM dhe të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve

### KËSHILLI GJYQËSOR I RM është kompetent:

- t'i zgjedh dhe shkarkoj gjyqtarët, kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët porotë;
- të konstatojë ndërprerje të funksionit të gjyqtarit;
- ta ndjek dhe vlerësojë punën e gjyqtarëve;
- të vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve;
- të konstatoj ushtrim joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit dhe ndërprerje të funksionit të gjyqtarit për shkak të paaftësisë së përhershme për ta ushtruar funksionin e gjyqtarit;
- të vendos për heqjen e imunitetit të gjyqtarit dhe në bazë të kërkesës të vendos për aprovimin e paraburgimit të gjyqtarit;
- të propozoj dy gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë nga radhët e gjyqtarëve;
- ta shqyrtoj raportin vjetor të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë për qëndrimet e përcaktuara parimore dhe opinionet parimore juridike sa u përket çështjeve të rëndësishme për sigurimin e unitetit gjatë zbatimit të ligjeve;
- të vendos për suspendimin e përkohshëm të gjyqtarit nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit;
- ta përcaktoj numrin e gjyqtarëve të nevojshëm nëpër gjykata;
- t'i shqyrtoj dhe vlerësoj raportet tremujore dhe vjetore të punës së gjykatave;
- të kujdeset për autoritetin e gjyqtarëve dhe për besimin e qytetarëve ndaj gjyqësorit;
- të paraqes raport për punën;
- të miratoj Rregullore pune dhe akte tjera të përgjithshme me të cilat i rregullon punët në kompetencë të tij;
- të përcaktoj numër të përafërt të lëndëve të cilat duhet t'i zgjidh gjyqtari në nivel mujor; dhe
- të kryej edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

#### Anëtari i Këshillit me të drejtë vote i ka këto të drejta, detyrime dhe përgjegjësi:

- merr pjesë në punën dhe vendimmarrjen e Këshillit,
- propozon iniciativa, propozime dhe mendime për çështje në kompetencë të Këshillit,
- merr pjesë në punën e trupave punues të Këshillit në të cilat është zgjedhur,
- sipas konkluzionit të Këshillit bën këqyrje në punën e gjyqtarit dhe ndërmerr veprime të tjera dhe për këtë paraqet raport deri te Këshilli,
- mban përgjegjësi për shkeljen e Kushtetutës dhe ligjit lidhur me ushtrimin e funksionit në Këshill, dhe
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

### KËSHILLI PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE është kompetent:

- i shqyrton iniciativat (parashtresat dhe ankesat), e paraqitura nga qytetarët, personat juridikë, nga kryetarët e gjykatave për punën e gjyqtarëve ose për zvarritjen e procedurave gjyqësore, por edhe në bazë të zërit të dëgjuar ose sipas informacioneve të tjera për punën e gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave;
- i siguron të dhënat dhe provat në lidhje me pretendimet e iniciativës;
- i siguron të dhënat dhe provat të cilat i posedon organi shtetëror, organi i njësisë së vetëqeverisjes lokale, personi fizik ose juridik të cilit i është besuar ushtrimi i autorizimeve publike;
- kryen këqyrje të drejtpërdrejt në dokumentet gjyqësore dhe në dokumente dhe dosje të tjera në lidhje me pretendimet e iniciativës;
- i shqyrton raportet e Këshillit Gjyqësor të RM për punën e gjyqtarëve dhe gjykatave;
- paraqet kërkesë për ngritjen e procedurës për përgjegjësinë e gjyqtarit ose kryetarit deri te Këshilli Gjyqësor i RM, si dhe e përfaqëson kërkesën e këtillë;
- harton raport vjetor për punët në kompetencë të tij dhe të kompetencave të tjera të përcaktuara me ligj.

## PROCEDURA E ZGJEDHJES SË GJYQTARIT

### Përcaktimi i numrit të nevojshëm të gjyqtarëve në gjykatat e RM

Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë me vendim e përcakton numrin e gjyqtarëve në çdo gjykatë (sipas nevojës së përcaktuar) dhe për vendimin e këtillë siguron mendim nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të RM.<sup>11</sup> Si dhe mendim nga mbledhja e gjyqtarëve të gjykatës përkatëse<sup>12</sup> që do të thotë rol aktiv dhe kompetencë të Këshillit Gjyqësor në krijimin e politikave për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve në gjyqësorin e RM.

Hapi i parë, në punën e Këshillit lidhur me procedurën e zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat themelore, është të miratohet vendimi me të cilin e përcakton numrin e vendeve vakante të gjyqtarëve në ato gjykata. Së këtejmi, merret parasysh numri i përgjithshëm i vendeve vakante për gjyqtarë në gjykatat themelore dhe projektimin e nevojave të vendeve të cilat do të plotësohen pas përfundimit të trajnimit fillestar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë dhe këtë vendim e dërgon deri te ky institucion, më së voni deri më 31 mars të vitit rrjedhës.

**Procedura e zgjedhjes** fillon me vendimin e Këshillit Gjyqësor për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e gjyqtarit, menjëherë pasi vendi i gjyqtarit të jetë vakant ose pas përcaktimit të nevojës për të njëjtin. Në vendim theksohet edhe specializimi i nevojshëm i fushës (fusha penale, civile, ekonomike ose fushë tjetër nga fushëveprimi i punës së gjykatës), ndërkaq konform kërkesës së parashtruar paraprakisht nga ana e gjykatës deri te Këshilli Gjyqësor, me të cilën kërkohet plotësimi i vendit të gjyqtarit. Shpallja publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, si dhe në dy gazeta, nga të cilat njëra në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase të cilën e flasin më së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe zgjatë 15 ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare.<sup>13</sup> Zgjedhja e gjyqtarit të gjykatës themelore lidhet ekskluzivisht me rank-listën e kandidatëve të paraqitur nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, me ç'rast Këshilli Gjyqësor e ka për detyrë zgjedhjen ta kryej sipas radhitjes konform suksesit të arritur të kandidatëve të përcaktuar në atë listë, të cilët janë paraqitur në konkurs. Në këtë mënyrë, në esencë KGJRM e bën emërimin e kandidatëve për gjyqtarë në gjykatat themelore sepse është i obliguar t'i respektojë rezultatet e arritura në kuadër të Akademisë.

<sup>11</sup> Mbledhjen e Përgjithshme të GJSRM e përbëjnë të gjithë gjyqtarët e GJSRM pavarësisht specializimit të tyre.

<sup>12</sup> Neni 44 i Ligjit për gjykata "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/06, 35/08, U. nr. 256/07, U. nr. 74/08, 150/10, U. nr. 12/11.

<sup>13</sup> Neni 39 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM.

KGJRM gjithashtu e bën **përzgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat më të larta** (Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë Administrative dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë) nga kandidatët e paraqitur në konkurs, të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me ligj, me ç'rast e bën rankimin e të njëjtëve sipas specializimit të nevojshëm për plotësimin e vendit të gjyqtarit.

Për zbatimin e drejtë të procedurës për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë, Këshilli Gjyqësor nga përbërja e vet formon komision prej tre anëtarësh, i cili e përgatit zbatimin efektiv të zgjedhjes.<sup>14</sup> Në kompetencë të këtij komisioni është kontrolli i paraqitjes në kohë i kandidatëve dhe kontrolli i dokumentacionit të plotë, përgatitja e listave të kandidatëve nga kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e nevojshme; njoftimi i kandidatëve për ditën dhe orën e realizimit të testit psikologjik dhe testit të integritetit, si dhe pagesën e kompensimit financiar për testimin e cila është në barrë të kandidatit. Pastaj, zbaton intervistë me kandidatët nga lista e kandidatëve të cilët e kanë kaluar testin psikologjik dhe testin e integritetit dhe krijon rank-listë përfundimtare të kandidatëve sipas specializimit të nevojshëm dhe rank-listë të kandidatëve të cilët nuk e posedojnë specializimin e nevojshëm.

Këshilli Gjyqësor gjatë zgjedhjes së gjyqtarit në gjykatë më të lartë sipas vlerësimit të tij në mënyrë të jashtëzakonshme ta vlerësoj punën e kandidatit dhe me vendim ta përcaktoj periudhën kohore për të cilën kandidati do të vlerësohet në mënyrë të jashtëzakonshme. Vlerësimin e jashtëzakonshëm e kryen komisioni prej tre anëtarësh nga radhët e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, sipas kriterëve dhe procedurës për vlerësimin e rregullt të punës së gjyqtarit.<sup>15</sup>

Në procedurën e zgjedhjes së gjyqtarit, në përputhje me Rregulloren e punës së Këshillit Gjyqësor i njëjti diskuton dhe merr vendim në mbledhje në të cilën marrin pjesë më së paku dy e treta e anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote.

Shqyrtimi zhvillohet sipas radhitjes, konform rank-listës përfundimtare të kandidatëve sipas specializimit të nevojshëm. Anëtarët e KGJRM kanë të drejtë të prononcohen për kandidatin para se të votojnë për të njëjtin. Nëse kandidati i rankuar i parë në listë nuk e fiton numrin e nevojshëm të votave (dy të tretën e shumicës), atëherë votohet sipas radhitjes për kandidatin e ardhshëm nga rank-lista. Do të zgjidhet për gjyqtar, kandidati i cili do të fitoj dy të tretën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote. Për zgjedhjen e bërë kandidati njoftohet me shkrim, ndërsa vendimi publikohet në ueb faqen e Këshillit dhe shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

<sup>14</sup> Neni 20 i Rregullores për punën e Këshillit Gjyqësor të RM.

<sup>15</sup> Neni 20 paragrafi 3, 4, 5 i Rregullores për punën e KGJRM.



Në vitin 2016 u bë përzgjedhja e më shumë gjyqtarëve – më datë 5 shtator u zgjodhën 25 gjyqtarë në të gjitha instancat. Nga elaborimi i Komisionit i cili i realizon intervistat u theksua se ka gjyqtarë të cilët kanë numër të barabartë të pikëve të përgjithshme për kandidatët e rankuar më lartë në listë.

Në mënyrë plotësuese, gjatë zgjedhjes së 2 gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë Administrative nuk u zgjodh kandidatja me numër më të madh të pikëve (e cila aktualisht është gjyqtare e Gjykatës Administrative) por 2 kandidatët e radhës (të cilët në atë moment ishin të punësuar në organet shtetërore ose nuk kishin përvojë gjyqësore). Në të dyja rastet e cekura, asnjëri nga gjithsej 12 anëtarët e pranishëm të KGJRM, nuk u paraqitën për fjalë që të prononcohen për kandidaturat, por vetëm përfaqësuesi i Komisionit shkurtimisht elaboroi lidhur me stazhin e tyre (për 25 kandidatët të cilët tanimë janë gjyqtarë).<sup>16</sup>

Procedura e **zgjedhjes së kryetarit të gjykatës** fillon me konkurs i cili publikohet dy muaj para skadimit të mandatit të kryetarit aktual. Zgjedhja e kryetarit nga kandidatët e paraqitur duhet të kryhet më së voni dy muaj pas shpalljes së konkursit.

Këshilli Gjyqësor i RM, nga viti 2016, filloi t'i publikojë vendimet për zgjedhjen e gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës në ueb faqen e vet. Megjithatë, vendimet për zgjedhjen e gjyqtarëve nuk përmbajnë informacione për kandidatët e paraqitur e as që japin sqarime për kualifikimet e kandidatëve të zgjedhur.

Në mënyrë identike, si edhe për zgjedhjen e gjyqtarit, kandidati i zgjedhur për kryetar njoftohet me shkrim, ndërsa vendimi për zgjedhjen publikohet në ueb faqen e Këshillit Gjyqësor, si dhe shpallet në Gazetën Zyrtare të RM.

Kur bëhet zgjedhja e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit e cila është në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes lokale në të cilën 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, si dhe e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, Këshilli Gjyqësor

doemos duhet ta respektoj parimin e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat. Në situata të këtilla diskuton dhe merr vendim në mbledhje në të cilën marrin pjesë më së paku dy e treta e anëtarëve me të drejtë vote, ndërkaq konsiderohet se është zgjedhur kandidati i cili ka fituar dy të tretën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote, me ç'rast doemos duhet të ketë shumicë të votave nga anëtarët e pranishëm të cilët u përkasin bashkësive të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.<sup>18</sup>

Nëse KGJRM, pas procedurës së zbatuar për zgjedhjen e gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës, konstaton se asnjëri nga kandidatët e paraqitur në konkurs nuk i plotëson kushtet e nevojshme, ose nuk është zgjedhur për gjyqtar ose për kryetar të gjykatës merr vendim për shpalljen e sërishme të këtyre vendeve vakante (për gjyqtar ose kryetar të gjykatës) me qëllim që të bëhet përzgjedhja.<sup>19</sup>

Këshilli nga radhët e gjyqtarëve, sipas notës paraprakisht të përcaktuar të rezultateve të tyre të përgjithshme të punës dhe kontributit për zhvillimin e mendimit profesional dhe teorik dhe sistemit juridik, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë i propozon dy kandidatë **për zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Administrative** të Republikës së Maqedonisë. Këtë propozim Këshilli Gjyqësor e përcakton me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote.<sup>20</sup>

16 Informacionet janë siguruar nga monitorimi i vazhdueshëm i mbledhjeve të KGJRM nga ana e Institutit për të Drejtat e Njeriut.

17 Информациите се добиени од континуирианиот мониторинг на седниците на ССРМ од Институтот за човекови права.

18 Neni 24 i Rregullores për punën e Këshillit Gjyqësor të RM.

19 Neni 25 i Rregullores për punën e Këshillit Gjyqësor të RM.

20 Neni 132 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM.

## KUSHTET PËR ZGJEDHJEN E GJYQARËVE DHE KRYETARËVE (TË PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA)

Në Ligjin për gjykata<sup>21</sup> janë parashikuar kushte të përgjithshme për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave të cilët janë baza për zbatimin e zgjedhjeve.

**KUSHTET E PËRGJITHSHME:** të jetë shtetas i RM, në mënyrë aktive ta zotëroj gjuhën maqedonase, të jetë i aftë për punë me gjendje të përgjithshme shëndetësore, jurist i diplomuar me mesatare prej më së paku tetë, me provim të dhënë të jurisprudencës, në mënyrë aktive ta njoh njërën nga gjuhët zyrtare të BE, prej të cilave detyrimisht gjuhën angleze, punë praktike me kompjuter, të gëzoj autoritet, të posedoj integritet për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe të posedojë aftësi sociale për ushtrimin e të njëjtit.)

### KUSHTET E VEÇANTA PËR ZGJEDHJEN E GJYQARËVE PËR

#### GJYKATËN THEMELORE

kandidati duhet ta ketë kryer trajnimin fillestar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

#### GJYKATËN E APELIT

duhet të ketë përvojë pune prej më së paku katër vjet stazh pune pa ndërprerje në Gjykatën Themelore deri në momentin e paraqitjes.

#### GJYKATËN ADMINISTRATIVE

duhet të ketë përvojë pune prej më së paku katër vjet stazh pa ndërprerje të gjyqtarit në Gjykatën Themelore ose pesë vjet stazh në punë juridike në organ shtetëror.

#### GJYKATËN E LARTË ADMINISTRATIVE

duhet të ketë përvojë pune prej më së paku tre vjet stazh pa ndërprerje të gjyqtarit në Gjykatën Administrative ose të ketë gjashtë vjet stazh në punë juridike në organ shtetëror.

#### GJYQTAR NË GJYKATËN SUPREME TË RM

duhet të ketë më së paku gjashtë vjet stazh pa ndërprerje në Gjykatën e Apelit ndërsa kandidatët e Gjykatës Administrative dhe Gjykatës së Lartë Administrative të jenë të vlerësuar me notë më të lartë pozitive.

Si **KUSHT PLOTËSUES** për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë nevojitet që, në vitin e fundit nga Këshilli Gjyqësor, të jenë të vlerësuar me notën më të lartë pozitive në raport me kandidatët e paraqitur të tjerë dhe në raport me të paraqiturit e tjerë të ketë numër më të madh të pikëve konform ligjit.

**KRYETARI I GJYKATËS** zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve në kushte, në procedurë dhe në mënyrë siç bëhet zgjedhja e gjyqtarëve në gjykata përkatëse.

Për kryetar të gjykatës zgjidhet gjyqtari i cili në dy vitet e fundit është vlerësuar me notë më të lartë pozitive, ndërsa në raport me kandidatët e paraqitur të tjerë ka numër më të madh të pikëve konform ligjit.

Kandidati për kryetar të gjykatës, aplikimit dhe dokumenteve të tjera ua bashkëngjijt programin e punës gjatë mandatit.

Kriteret e vlerësimit të gjyqtarëve, të cilat janë të rëndësishme për avancimin e tyre të mëturshëm, janë të paqarta dhe nuk janë plotësisht të definuara dhe çojnë në konfuzion, se a zbatohen në mënyrë të drejtë në praktikë. Në këtë aspekt vlerësohet vetëm numri i vendimeve të konfirmuara, shfuqizuara ose të modifikuara në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura, si dhe me numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e përafërt të lëndëve që duhet t'i zgjidh gjyqtari brenda një muaji, të dhëna këto të cilat fitohen përmes sistemit AKMIS, pa të dhëna për parametrat e tjerë të cilët e përcaktojnë raportin ndaj punës siç janë bazat e lëndëve të zgjidhura, si dhe kualifikimet e tjera për peshën e lëndës.

Një çështje shumë e rëndësishme në procesin e zgjedhjes së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, gjithsesi se është përcaktimi i kriterëve përkatëse ligjore të cilat në tërësi do të mundësojnë një përzgjedhje cilësore nga më shumë aspekte, siç është shkalla e lartë e profesionalizmit dhe kompetencës të konfirmuara përmes praktikimit cilësor të numrit adekuat të viteve e që siguron përvojë pune cilësore dhe gjithsesi shkallë të lartë të integritetit të gjyqtarit si personalitet me cilësi të larta morale.

Së këtejmi, nuk duhet të neglizhohet çështja e zbatimit të drejtë dhe të plotë e këtyre kriterëve gjatë realizimit të çdo zgjedhjeje të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave pa lejimin e voluntarizmit në punën e Këshillit Gjyqësor dhe ndikimeve politike nga ana e pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv.

Sa i përket zgjedhjes së gjyqtarëve në Gjykatën Themelore, në përputhje me kriterin e përcaktuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor,<sup>22</sup> përzgjedhjen e bën Këshilli Gjyqësor sipas radhitjes konform suksesit të arritur të përcaktuar në rank-listën përfundimtare.

*Në asnjë vend nuk përmendet specializimi i kandidatëve të cilët e kanë kryer trajnimin fillestar edhe pse në gjykatat themelore, në të cilat ata paraqiten, ekziston specializimi duke e pasur parasysh kompetencën e gjykatës për veprim në procedurë të parashikuar me ligj, edhe atë: për të drejtat e njeriut dhe qytetarit dhe për interesat që kanë bazë juridike, për konteste midis qytetarëve dhe subjekteve të tjerë juridikë, për vepra penale dhe kundërvajtje dhe për çështje të tjera të cilat me ligj janë përcaktuar si kompetencë e gjykatës.<sup>22</sup>*

Ndërsa për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë: Gjykatën e Apelit, Gjykatën Administrative, Gjykatën e Lartë Administrative dhe në Gjykatën Supreme të RM, Këshilli

<sup>22</sup> Neni 40 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM.

<sup>23</sup> Neni 4 i Ligjit për gjykata, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/06, 35/08, U. nr. 256/07, U. nr. 74/08, 150/10, U. nr. 12/11.

<sup>24</sup> Член 4 од Законот за судовите, Службен весник на Република Македонија" бр.58/06, 35/08, У. бр.256/07, У.бр.74/08, 150/10, У.бр.12/11.

<sup>21</sup> Neni 45 dhe 45-a, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/06,35/08, U. 256/07, U. nr. 74/08,150/10, U. nr. 12/11.

Gjyqësor e bën zgjedhjen e gjyqtarit në atë mënyrë që kandidatët e paraqitur i rankon sipas specializimit të nevojshëm për plotësimin e vendit të gjyqtarit.

*Kandidatët për gjyqtarë në gjykatat më të larta fitojnë specializim gjatë punës së tyre dhe gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatat Themelore e që është relativisht e saktë meqë edhe kandidatët e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë manifestojnë interesim dhe sukses të veçantë për një fushë të caktuar nga trajnimi fillestar e që u jep përparësi në një fushë të caktuar, ndërkaq kjo përparësi do të duhej të evidentohet nga ana e institucionit i cili e paraqet rank-listën, ndërsa me këtë lehtësohet puna e Këshillit Gjyqësor gjatë plotësimit të një vendi konkret të gjyqtarit nga fusha penale, civile ose nga ndonjë fushë tjetër.*

Këshilli Gjyqësor gjatë përzgjedhjes së gjyqtarit e ka për detyrë t'i respektoj kriteret e parashikuara në Ligjin për Këshillin Gjyqësor dhe ta zgjedh kandidatin me cilësi më të larta profesionale dhe specialiste, ndërkaq njëkohësisht të gëzoj edhe autoritet për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Kriteret e parashikuara në Ligjin për Këshillin Gjyqësor<sup>25</sup> janë në funksion të ofrimit të seleksionimit më efikas gjatë rankimit të kandidatëve, zbatimi i të cilave siguron efektivitet më të madh në punën e Këshillit Gjyqësor sa i përket procesit të zgjedhjes së gjyqtarit në gjykatë më të lartë.

**Nga aspekti i cilësive profesionale dhe specialiste** si dhe nga aspekti i autoritetit:

- Në **vend të parë** është kriteri i cili e **vlerëson njohurinë profesionale dhe specializimin në profesion** dhe pjesëmarrjen në trajnime të vazhdueshme;
- Në **vend të dytë është raporti ndaj punës**, me ç'rast merret parasysh respektimi i afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve procesuale, respektimi i afateve ligjore për miratimin, publikimin dhe përpilimin e vendimeve, relacioni midis numrit të vendimeve të verifikuara, të shfuqizuara ose të modifikuara në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura, numrin e lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e përafërt të lëndëve të cilat duhet t'i zgjidh gjyqtari në nivel mujor i përcaktuar nga Këshilli Gjyqësor;
- **në vend të tretë është aftësia për zgjidhjen e çështjeve juridike**, me ç'rast merret parasysh shkalla e arritur e drejtësisë dhe ligjshmërisë së vendimeve dhe konstatimeve gjyqësore, para së gjithash në procedurat me instrumentet juridike;


- **në vendin e katër është ruajtja e autoritetit të gjyqtarit dhe gjykatës**, që përcaktohet nga mënyra e zhvillimit të procedurës, nga komunikimi me palët dhe organet e tjera, nga ruajtja e pavarësisë, paanshmërisë, besueshmërisë, rëndësisë dhe sjelljes ndaj punës dhe jashtë punës;
- **në vend të pestë është aftësia për shprehje verbale dhe me shkrim**, e që mund të shihet përmes vendimeve të përpiluara dhe veprimit profesional gjyqësor;
- **në vend të gjashtë** ndërmarrja e punës plotësuese gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit me pjesëmarrje në zgjidhjen e lëndëve të prapambetura;
- **në vend të shtatë** ndërmarrje e punës plotësuese gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit përmes mentorimit, edukimit dhe ngjashëm; në vend të tetë është relacioni me bashkëpunëtorin dhe administratën gjyqësore dhe në vend të nëntë është aftësia për kryerjen e detyrave me karakter udhëheqës.

Përveç zbatimit të kriterëve të lartpërmendura për zgjedhjen e drejtë të gjyqtarit në gjykatë më të lartë, **KGJRM e ka për detyrë të siguroj mendim nga gjykata** të cilin mendim pastaj ia dërgon Kryetarit të gjykatës pas mbledhjes së mbajtur të gjyqtarëve dhe **zbaton anketa anonime me të punësuarit në gjykatë** në të cilën kandidatët e ushtrojnë funksionin e gjyqtarit. Për kandidatin për gjyqtar në Gjykatën Administrative ose në Gjykatën e Lartë Administrative i cili nuk është nga radhët e gjyqtarëve, Këshilli Gjyqësor siguron mendim nga organi shtetëror në të cilin punon kandidati.

*Sa i përket anketës anonime në Ligjin për Këshillin Gjyqësor është përcaktuar se mënyrën e zbatimit e rregullon KGJRM megjithatë, nga këqyrja e bërë në Rregulloren e punës të Këshillit Gjyqësor ku rregullohet veprimi i Këshillit Gjyqësor gjatë zgjedhjes së gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës, nuk ka dispozita sa i përket mënyrës së zbatimit të anketës anonime me të punësuarit e gjykatës dhe për këtë nuk kemi informacione nëse zbatohet dhe rezultatet e kësaj ankete a merren parasysh gjatë vendimeve për zgjedhjen e gjyqtarit.*

<sup>25</sup> Neni 41 paragrafi 2 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor.

## N GRITJA E PROCEDURËS DISIPLINORE KUNDËR GJYQTARËVE DHE PROCEDURËS PËR SHKARKIMIN E GJYQTARËVE



### Kërkesa e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve për Ngritjen e Procedurës Disiplinore (në tekstin në vijim: Kërkesa), i dërgohet Këshillit Gjyqësor bashkë me provat mbi të cilat bazohet kërkesa.

Këshilli Gjyqësor në rastin e kërkesës së paraqitur për procedurë disiplinore diskuton vetëm në lidhje me atë se kërkesa a është paraqitur në kohë, a është e plotë dhe e lejuar. Nëse Këshilli Gjyqësor gjen se kërkesa nuk është paraqitur në kohë, nuk është e plotë ose është e palejuar me vendim do ta hedhë poshtë kërkesën. Nëse Këshilli Gjyqësor e aprovon kërkesën Këshilli prej radhëve të veta formon komision disiplinor i cili përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë (në tekstin në vijim: Komisioni). Këshilli Gjyqësor prej radhëve të veta përcakton një zëvendës kryetar të Komisionit dhe një zëvendës të anëtarëve të Komisionit, zëvendësi i anëtarëve të Komisionit mund të zëvendësoj vetëm një anëtar gjatë zhvillimit të mbledhjeve dhe diskutimeve.

Komisioni kërkesën dhe provat ia dorëzon personalisht gjyqtarit kundër të cilit është ngritur. Gjyqtari mund t'u përgjigjet me shkrim pretendimeve të kërkesës ose të jap deklaram verbal në procesverbal, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës. Gjyqtarit kundër të cilit është ngritur kërkesa e ka të drejtën e mbrojtësit të cilin e njofton dhe e siguron ai vet. Bashkë me përgjigjen e kërkesës, gjyqtari i paraqet të gjitha provat në bazë të të cilave e bazon përgjigjen e vet ndaj kërkesës ose me të cilat i përgënjeshtrojnë pretendimet dhe provat e kërkesës. Komisioni, përmes kërkesës, siguron të dhëna dhe prova të cilat janë me interes për përcaktimin e gjendjes lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit.

Në bazë të dhënave dhe provave të siguruara, Komisioni në afat prej 30 ditësh deri te Këshilli Gjyqësor paraqet raport me propozim për bazueshmërinë e kërkesës.

Këshilli Gjyqësor në mbledhje e shqyrton kërkesën dhe propozimin e Komisionit dhe vendos për ngritjen e procedurës disiplinore ose për ndërprerjen e procedurës

disiplinore. Këshilli Gjyqësor e miraton vendimin me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të raportit.

Nëse gjyqtari, kundër të cilit zhvillohet procedura disiplinore, paraqet kërkesë për ndërprerjen e funksionit të gjyqtarit, Këshilli Gjyqësor në vendimin për ndërprerjen e funksionit të gjyqtarit, sipas kërkesës së tij, do të konstatoj ndërprerje të funksionit të gjyqtarit sipas kërkesës së tij në të cilin do të shënohet se i njëjti është miratuar gjatë kohës kur kundër gjyqtarit është zhvilluar procedura disiplinore. Në këtë rast ndërpritet procedura disiplinore.

Gjyqtari shkarkohet nga funksioni i gjyqtarit për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit.

Këshilli Gjyqësor e shkarkon gjyqtarin ose kryetarin e gjykatës, në kushte dhe procedurë të përcaktuar me ligj. *Kjo procedurë ngritet me kërkesë të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë edhe atë në afat prej një viti nga dita kur kuptohet për shkeljen e kryer.* Procedura është urgjente dhe me karakter të besueshëm. Zhvillohet pa prezencën e publikut dhe me respektimin e autoritetit dhe dinjitetit të gjyqtarit, me ç'rast mbahet llogari për mbrojtjen e të dhënave personale të gjyqtarit, megjithatë, me kërkesë të tij mund të vendos procedura të zhvillohet me prezencën e publikut.<sup>26</sup>

Procedura për përcaktimin e ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit, megjithatë, nuk mund të ngritet nëse kalojnë më shumë se pesë vjet nga dita e shkeljes së kryer. Ekziston përjashtim nga ky rregull në rastin kur është miratuar vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për shkak të shkeljes së nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose në rastin kur është miratuar vendim nga ana e Gjykatës Supreme të RM lidhur me të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm, si rezultat i veprimit të gjyqtarit për të cilin është ngritur procedura për përcaktimin e ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit (neni 78 paragrafi 4 nga LKGJRM).

Pas procedurës së zbatuar, Këshilli i Fakteve vendimin për shkarkimin e gjyqtarit e miraton me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote. Këshilli i Fakteve përkohësisht mund ta largoj gjyqtarin nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit kur është ngritur procedurë për shkarkimin e tij ose kur është ngritur procedurë disiplinore.

<sup>26</sup> Neni 39 i Ligjit për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, "Gazeta Zyrtare e RM" nr. 20, 12.02.2015.

Këshilli i Fakteve në bazë të raportit dhe diskutimit në mbledhje merr vendim për paraqitjen e kërkesës deri te Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit ose kryetarit të gjykatës. Këshilli i Fakteve do ta refuzoj iniciativën nëse konstaton se është e pabazuar për shkak të mosekzistimit të provave për atë se gjyqtari ka bërë shkelje në përputhje me ligjin.

Kundër aktvendimit për shkarkim ose për shqiptimin e masës disiplinore, gjyqtari ose kryetari i gjykatës, në afat prej tetë ditësh, ka të drejtë ankese deri te Këshilli për vendimmarrje sipas ankesave të Këshillit Gjyqësor, i formuar pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë.

Këshillit Gjyqësor në mbledhje vendos **edhe për heqjen e imunitetit** të gjyqtarit në rastet e përcaktuara me ligj, me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote. Këshilli Gjyqësor në mbledhje, mes tjerash, vendos edhe për kërkesën për aprovimin e paraburgimit të gjyqtarit, përkatësisht në bazë të njoftimit se gjyqtari është paraburgosur.

Në këtë procedurë Këshilli Gjyqësor ka mundësi që në bazë të njoftimit për paraburgimin e gjyqtarit i cili nuk është thirrur në imunitet, të vendos që të zbatohet imuniteti i gjyqtarit, nëse vlerëson se një gjë e këtillë është e nevojshme për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit.

Gjatë ushtrimit të kësaj pune nga kompetenca e vet, Këshilli Gjyqësor vlerëson çka është e nevojshme për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit pa cekur nevoja relevante konkrete, që mund të rezultojë me selektivitet gjatë zbatimit të kësaj mundësie.

*Gjatë muajit korrik të vitit 2016 Këshilli Gjyqësor e shqyrtoi Kërkesën për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit, sipas Vendimit të Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit dhe u miratua Aktvendim me të cilin hidhet poshtë kërkesa për përcaktimin e përgjegjësisë së gjyqtarit për shkak të ushtrimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit të gjyqtarit, të paraqitur nga Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit.*

Mbledhjet në të cilat Këshilli Gjyqësor i RM diskuton për shqiptimin e masës disiplinore ose për shkarkimin e gjyqtarit nuk janë të hapura për publikun. Vendimet për shqiptimin e masës disiplinore ose për shkarkimin e gjyqtarit, KGJRM duhet t'i publikoj në ueb faqen e vet vetëm me inicialet e gjyqtarit dhe gjykatën në të cilën punon. Megjithatë, Këshilli Gjyqësor gjatë viteve të kaluara nuk i ka publikuar vendimet e procedurës disiplinore ose vendimet për shkarkimin e gjyqtarit.

## RISHPËRNDARJE E GJYQTARËVE

Shpërndarja e gjyqtarëve bëhet me shpërndarjen vjetore të punëve, të cilën e përcakton kryetari i gjykatës, në bazë të mendimit paraprakisht të siguar nga mbledhja e gjyqtarëve (kur bëhet fjalë për gjykatat, përveç Gjykatës Supreme të RM), përkatësisht në bazë të mendimit nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme (kur bëhet fjalë për Gjykatën Supreme të RM), së këtejmi duke mbajtur llogari për përcaktimin e gjyqtarit lidhur me specializimin në fushën penale, civile, ekonomike, administrative ose në ndonjë fushë tjetër juridike.<sup>27</sup>

Gjatë përcaktimit të kryetarëve të seksioneve dhe njërive të specializuara respektohet stazhi i gjyqtarit dhe rezultatet e punës, gjyqtari nuk mund të transferohet nga një njësi gjyqësore në tjetër kundër vullnetit të tij, megjithatë, gjyqtari mund të kërkoj transferim nga një njësi në njësi tjetër.

Me përjashtim, gjyqtari mund të transferohet në një njësi tjetër gjyqësore kundër vullnetit të tij me vendim të arsyetuar me shkrim të kryetarit të gjykatës në bazë të mendimit paraprakisht të siguar nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, kur një gjë e këtillë e kërkon vëllimi i rritur i lëndëve të punës në gjykatë, megjithatë, jo më shumë se një vit. Me përjashtim, gjyqtari i Gjykatës së Apelit dhe i Gjykatës Themelore, përkohësisht mund të transferohet, por jo më shumë se një vit, në gjykatë tjetër të shkallës së njëjtë ose në gjykatë më të ulët apo nga njëra njësi e specializuar në njësi tjetër, në rastin kur gjyqtari është penguar ose përjashtuar ose për shkak të vëllimit jashtëzakonisht të madh të punës, azhurnitetit të zvogëluar ose për shkak të kompleksitetit të lëndëve është vënë në pikëpyetje puna rrjedhëse e gjykatës. Transferimin e përkohshëm të gjyqtarit e bën Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë dhe për këtë menjëherë e njofton kryetarin e gjykatës nga e cila transferohet, si dhe kryetarin e gjykatës në të cilën gjyqtari transferohet përkohësisht.

Kundër vendimit për shpërndarjen e gjyqtarëve, të miratuar nga kryetari i gjykatës, gjyqtari mund të paraqes kundërshtim deri te Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, e cila e ka për detyrë, në afat prej tetë ditësh, të vendos për kundërshtimin.

Kundër vendimeve të Këshillit Gjyqësor të RM për transferimin e përkohshëm, gjyqtari mund të paraqes kundërshtim në afat prej tre ditësh deri te Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë. Vendimi i Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë është përfundimtar, me atë që në këtë rast, sipas ligjit, organi i njëjtë vendos në dy instanca.

27 Neni 39 i Ligjit për gjykata, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/06, 35/08, U. nr. 256/07, U. nr. 74/08, 150/10, U. nr. 12/11.

28 Komunikatë e Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup, e publikuar në: <http://www.osskopje1.mk/>. (Vizituar më datë 17.10.2016).

*Rishpërndarja e gjyqtarëve, megjithatë, ndodh edhe pa konsultim me gjyqtarët. Kryetari i Gjykatës Themelore Shkup 1 Shkup, vitin e kaluar, pa konsultim, vendosi të bëjë rishpërndarje duke iu referuar planit vjetor të punës.*

*Gjykata Themelore Shkup 1 në komunikatën për publikun, e arsyeton rishpërndarjen e gjyqtarëve të cilët, siç theksohet, janë pjesë të ndryshimeve organizative të shpërndarjes vjetore të gjyqtarëve në këtë Gjykatë, të miratuara nga ana e kryetarit të Gjykatës.1*

Ligji për gjykata, e rregullon shpërndarjen vjetore të punës së gjyqtarëve.<sup>29</sup> Shpërndarjen e punëve e përcakton kryetari i gjykatës, në bazë të mendimit paraprakisht të siguar nga mbledhja e gjyqtarëve. Gjatë përcaktimit të shpërndarjes gjithsesi se duhet të mbahet llogari edhe për përcaktimin e gjyqtarëve për specializim në ndonjë materie të caktuar.

Shpërndarja e gjyqtarit në punë joadekuate për lëndë për të cilat nuk posedon njohuri dhe specializim adekuat, mund të pasqyrohet negativisht në punën e gjyqtarit sa i përket cilësisë dhe kuantitetit të tij gjatë vendimmarrjes, e që si përfundim mund të gjeneroj ngritje të procedurës për punë joprofesionale dhe të pandërgjegjshme.

Gjithashtu, si një rrezik për pavarësinë mund të konsiderohet marrja e lëndës nga një gjyqtar dhe rishpërndarjen e lëndës së njëjtë tek një gjyqtar tjetër. Në mënyrë që të shmangen rastet e këtilla, duhet të respektohet shpërndarja vjetore e punëve dhe ligji për gjykata, ku përcaktohet se:

“Lëndët, të cilat paraqiten në gjykatë për vendimmarrje, u shpërndahen gjyqtarëve sipas kohës së pranimit të lëndës në gjykatë, duke e përjashtuar çdo ndikim mbi mënyrën e shpërndarjes nga ana e kryetarit të gjykatës, gjyqtarit ose administratës gjyqësore.”<sup>30</sup>

## PUNA E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM DHE KËSHILLIT TË FAKTEVE

Punët, në kompetencë të tij, Këshilli Gjyqësor i shqyrton dhe merr vendim në mbledhje të cilat janë publike, publiku mund të përjashtohet vetëm me vendim të Këshillit Gjyqësor për shkak të mbrojtjes së autoritetit dhe integritetit të gjyqtarit ose kandidatit për gjyqtar. Sa i përket përjashtimit të publikut nga mbledhjet, Këshilli Gjyqësor vendos me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit me të drejtë vote. Për rrjedhën e mbledhjes së Këshillit mbahet procesverbal dhe shënime stenografike.<sup>31</sup>

Këshilli Gjyqësor miraton Rregulloren pune, me të cilën rregullohet procedura dhe mënyra e punës së Këshillit Gjyqësor, si dhe çështje të tjera në kompetencë të tij. Mbledhjet i thërret dhe me të njëjtat kryeson Kryetari i Këshillit Gjyqësor. Kryetari e ka për detyrë të thërras mbledhje edhe në bazë të propozimit me material të përgatitur nga më së paku një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit. Mbledhja mund të mbahet nëse merr pjesë shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, nëse ndryshe nuk është caktuar me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë ose me Rregulloren. Propozimi i rendit të ditës konstatohet me shumicën e votave nga anëtarët e pranishëm.

Ftesa për mbledhje, me propozim rendin e ditës dhe me materialet, u dërgohet anëtarëve të Këshillit më së paku 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes. Për çështje urgjente dhe të paprolongueshme, mbledhja e Këshillit mund të caktohet dhe të mbahet edhe në afat më të shkurtër.

**Këshilli vendimet e tij i miraton me votim. Anëtari i Këshillit voton “Pro” ose “Kundër” (nuk mund të jetë i përmbytur).**

**Anëtari i Këshillit i ka këto të drejta, detyrime dhe përgjegjësi:** merr pjesë në punimet dhe në vendimmarrjen e Këshillit; propozon iniciativa, propozime dhe mendime për çështje në kompetencë të Këshillit; merr pjesë në punën e trupave punues të Këshillit në të cilët është zgjedhur; në bazë të konkluzionit të Këshillit e kontrollon punën e gjyqtarit dhe ndërmerr veprime të tjera dhe për këtë Këshillit i paraqet raport; ka përgjegjësi për shkeljen e Kushtetutës dhe ligjit lidhur me ushtrimin e funksionit në Këshill, kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë.

**Këshilli me vendim e përcakton numrin e nevojshëm të gjyqtarëve për çdo gjykatë.** Në mbledhje Këshilli merr vendim për formimin e komisioneve

29 Neni 39 paragrafi 4, Ligji i gjykatave, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/06, 35/08, U. nr. 256/07, U. nr. 74/08, 150/10, U. nr. 12/11.

30 Neni 7, Ligji për gjykata, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/06, 35/08, U. nr. 256/07, U. nr. 74/08, 150/10, U. nr. 12/11.

31 Ligji për Këshillin Gjyqësor, neni 33.

tre anëtarëshe të Këshillit për përcaktimin e numrit të nevojshëm të gjyqtarëve. Komisionet, në bazë të të dhënave të siguruar nga sistemi AKMIS, i analizojnë dy vitet e fundit të çdo gjykate. Analiza kryhet në bazë të të dhënave për numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve të gjykatës; numrin e përgjithshëm të lëndëve në punë të gjykatës; numrin e përgjithshëm të lëndëve të pazgjidhura; prurjen e lëndëve të reja; normën e përafërt mujore; përballjen me lëndët e pazgjidhura të prapambetura, si dhe për rrethanat tjera të cilat ndikojnë në përcaktimin e numrit të gjyqtarëve.

Pas analizës së realizuar, komisionet hartojnë raport i cili i dërgohet Kryetarit të Këshillit. Kryetari i Këshillit thërret mbledhje në të cilën Këshilli diskuton për raportet e komisioneve dhe i shqyrton raportet dhe mendimet e siguruar nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe nga mbledhja e gjyqtarëve të gjykatës në fjalë dhe pas kësaj merr vendim me të cilin përcaktohet numri i gjyqtarëve të çdo gjykate. Këshilli, më së paku një herë në vit, bën analiza për përcaktimin e nevojës për reduktimin ose rritjen e numrit të gjyqtarëve.

### Transparenca e punës së KGJRM

Këshilli Gjyqësor i RM në internet faqen e tij rregullisht i publikon komunikatat e mbledhjeve të caktuara me rend dite, si dhe i publikon pikat e miratuara ose vendimet në mbledhjen paraprake.

Komunikatat për publikun, sa u përket aktiviteteve të KGJRM, po ashtu publikohen rregullisht. Dokumente të tjera më të shpeshta të cilat i publikon Këshilli Gjyqësor janë konkurset për zgjedhjen e gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës, programet vjetore të punës, njoftimet për vizita studimore të anëtarëve dhe ngjashëm. Megjithatë, mungon sistematizimi i publikimeve, kështu që në pjesën “shpallje”, “vendime” ose “dokumente” publikimet e fundit janë nga viti 2010. Përveç kësaj, vendimet dhe procesverbalet integrale publikohen shumë rrallë.

Në përdorim është portali i ri, i cili ka për qëllim në një vend t’i grumbulloj të gjitha faqet e internetit të gjykatave në RM, përfshirë këtu edhe faqen e Këshillit Gjyqësor të RM. Ky portal, i emërtuar si “Portali gjyqësor i Republikës së Maqedonisë”<sup>32</sup> duhet t’i zëvendësojë faqet ekzistuese duke i ofruar të gjitha informacionet e grumbulluara në një vend dhe të mundësojë një pasqyrë më të madhe të informacioneve.

Mbledhjet e Këshillit Gjyqësor janë publike, përveç në rastet kur ka kushte për përjashtimin e publikut. Megjithatë, një element i rëndësishëm në sigurimin e transparencës është cilësia e diskutimeve dhe transparenca e institucionit në praktikë.

### Transparenca e punës së Këshillit të Fakteve

Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve u miratua në muajin shkurt të vitit 2015. Edhe pse mbledhjet e këtij Këshilli janë publike sipas ligjit, publiku ashtu si edhe tek Këshilli Gjyqësor mund të përjashtohet vetëm me vendim për shkak të mbrojtjes së autoritetit dhe integritetit të gjyqtarit ose kandidatit për gjyqtar, megjithatë ky organ nuk është vizibil për publikun e gjerë.

Këshilli i Fakteve nuk posedon ueb faqe, ndërkaq komunikatat nuk i publikon përmes ndonjë media tjetër. Rregullorja e punës dhe aktet e tjera nënligjore të këtij organi nuk janë të aksesshme për publikun edhe pse këtij organi i është besuar roli që t’i trajtoj veç e veç të gjitha parashtrirat dhe ankesat e paraqitura nga qytetarët, personat juridikë, kryetarët e gjykatave për punën e gjyqtarëve ose për punën e kryetarëve të gjykatave, për zvarritjen e procedurave gjyqësore, si dhe në bazë të zërit të dëgjuar apo në bazë të informatave të tjera për punën e gjyqtarëve ose kryetarëve të gjykatave.

32 I aksesshëm në: <http://sud.mk/>.

## LOGARIDHËNIA DHE PËRGJEGJËSIA E KËSHILLIT GJYQËSOR TË RM

Këshilli për punën e vet paraqet **raport vjetor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë**. Raporti është publik dhe i njëjti përmban të dhëna për numrin e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë të zgjedhur dhe shkarkuar, për numrin e procedurave disiplinore të ngritura dhe të përfunduara për gjendjen kadrovike të gjyqësorit, për gjendjen materiale-financiare të gjyqësorit, për vlerësimin e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të gjykatave me organet e tjera të jurisprudencës dhe me organet e pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv, vlerësimin e gjendjes të gjyqësorit sa i përket mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe për të dhënat sa i përket procedimit të parashtresave dhe propozimeve nga qytetarët dhe institucionet për punën e gjyqtarëve dhe gjykatave.

*Raporti përmban edhe vlerësim për punën e gjyqtarëve në Republikën e Maqedonisë lidhur me efikasitetin e punës së tyre, si dhe për çështje tjera në lidhje me realizimin e pavarësisë dhe mëvetësisë së gjyqësorit.*

Këshilli Gjyqësor, këtë raport e miraton në mbledhje me dy të tretën e shumicës së votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve me të drejtë vote dhe pastaj e paraqet në Kuvendin e RM-së për shqyrtim dhe miratim. Pas miratimit të raportit, Këshilli të njëjtin ua dërgon të gjitha gjykatave në Republikën e Maqedonisë.<sup>33</sup>

*Në qoftë se Kuvendi i RM-së nuk e miraton raportin, kjo do të jetë bazë për hapjen e diskutimit para organeve të cilat i kanë zgjedhur anëtarët e Këshillit Gjyqësor për vlerësimin e punës së tyre.<sup>33</sup>*

Praktika e deritanishme, sa i përket miratimit të raportit të Këshillit Gjyqësor në Kuvendin e RM-së nuk vë në dukje diskutime serioze të përbërjes parlamentare dhe nuk është evidentuar ndonjë rast të mosmiratimit të tij, e që do të jetë shkas për rishikimin e punës së anëtarëve para organeve që i kanë zgjedhur. Për shkak të qasjes së këtyllë pasive, ndaj raportit për punën e Këshillit Gjyqësor, nuk mund të jepet ndonjë vlerësim për efikasitetin e punës së tij.

Në këtë aspekt mund të vërehet se pas miratimit të raportit të punës dhe

dërgimit të tij deri te të gjitha gjykatat e RM-së nënkupton transparencë në punë, ndërkaq i njëjti do të kishte peshë më të madhe meqë edhe në gjykata mungon shqyrtimi dhe diskutimi serioz i të njëjtit edhe pse kjo është një mundësi e mirë që gjykatat të prononcohen për punën së paku të anëtarëve të cilët i kanë zgjedhur nga radhët e tyre.

Raporti duhet ta përmbaj trajtimin e çështjeve dhe vlerësimeve të rëndësishme lidhur me gjendjet e gjyqësorit, si nga aspekti i gjendjes kadrovike, ashtu edhe nga aspekti i gjendjes materiale-financiare, marrëdhëniet me organet e tjera të jurisprudencës dhe me organet e pushtetit ligjvënës dhe ekzekutiv. Raporti përmban edhe vlerësime për punën e gjyqtarëve në Republikën e Maqedonisë, si dhe çështje tjera në lidhje me realizimin e pavarësisë dhe mëvetësisë së gjyqësorit.

Trajtimi i këtyre çështjeve të rëndësishme në këtë raport, si dhe oferta për zgjidhjen e të njëjtave do të ishin interesante si për publikun profesionist ashtu edhe për publikun më të gjerë dhe, së këtejmi, publikimi i tij do të ishte edhe një hap në drejtim të punës transparente dhe llogaridhënese të Këshillit Gjyqësor të RM-së.

## LOGARIDHËNIA DHE PËRGJEGJËSIA E KËSHILLIT PËR PËRCAKTIMIN E FAKTEVE

Puna e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve mbetet e panjohur meqë në Ligj nuk është parashikuar kurrfarë llogaridhënie dhe përgjegjësi të anëtarëve të tij. Ky organ, sipas nenit 32 paragrafi 8 të Ligjit, e ka për detyrë vetëm të hartoj raport vjetor për punët në kompetencë të tij, të cilin e publikon në ueb faqen e vet, më së voni deri më 1 shkurt të vitit rrjedhës për vitin paraprak. Megjithatë, kurrfarë transparence ose llogaridhënie tjetër nuk është parashikuar për punën e tij edhe pse ai nuk mund të ekzistoj ndaras nga Këshilli Gjyqësor duke e pasur parasysh kompetencën e tij për ngritjen e procedurës për përgjegjësinë e gjyqtarit ose të kryetarit të gjykatës deri te Këshilli Gjyqësor.


33 Neni 135 paragrafi 7 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RM.




## ANALIZA E PYETËSORËVE TË DËRGUAR DERI TE PUBLIKU PROFESIONIST (AVOKATËT)

Instituti për të Drejtat e Njeriut përpiloi pyetësorë në mënyrë që ta konstatojë perceptimin momental dhe njohuritë e publikut të gjerë dhe profesionist për punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit për Përcaktimin e Fakteve. Pyetësorët për publikun profesionist iu dërguan 2000 avokatëve në tetor të vitit 2016, ndërsa përgjigje pranuan nga 137 avokatë. Përgjigjet e pyetjeve janë prezantuar në sqarimet si vijojnë.


1. Në pyetjen e Anketës **“A jeni të njoftuar me punën e Këshillit Gjyqësor të RM?”** të anketuarit në numrin më të madh të rasteve (86.8%) janë përgjigjur në mënyrë pohuese se janë të njoftuar, ndërsa në 11.5 % janë përgjigjur se nuk janë të njoftuar me punën e KGJRM.




2. Në pyetjen e dytë për **njohuritë me punën e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit**, 67.8 % janë përgjigjur me PO, ndërsa 28.9 % me JO dhe 3.3% kanë dhënë përgjigje tjera.




3. Në pyetjen: **A është Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë organ i pavarur dhe i mëvetësishëm?** avokatët në 90.2 % janë përgjigjur me JO, ndërsa 4.9 % kanë dhënë përgjigje pohuese dhe po aq 4.9% kanë dhënë përgjigje të tjera.



4. Lidhur me pyetjen **A e respektojnë organet, institucionet dhe trupat e tjerë pavarësinë e Këshillit Gjyqësor në RM?** 85.2% e avokatëve janë përgjigjur se nuk e respektojnë pavarësinë e Këshillit, 7,4% janë përgjigjur se e respektojnë. Pjesa tjetër prej 7,4% kanë dhënë përgjigje të tjera.




5. Gjysma e avokatëve në pyetjen **"A kanë paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit?"** janë përgjigjur se kanë paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit.




6. Në pyetjen **"Sa herë deri më tani keni paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit dhe për cilat shkaqe?"** nga aspekti kuantitativ avokatët më së shpeshti janë përgjigjur në diapazonin prej 2 deri në 10 kërkesa të paraqitura, ndërsa si shkaqe më së shpeshti theksohen "... gjykimi i njëanshëm dhe lidhjet miqësore, veprimi joprofesional, mosrespektimi i procedurës, zvarritja e procedurave dhe ngjashëm."

7. Nga përgjigjet e pyetjes **"Sa prej kërkesave janë aprovuar nga kryetari i gjykatës?"** numri më i madh i avokatëve, të cilët kanë paraqitur kërkesë për përjashtim, janë përgjigjur se kërkesat nuk u janë aprovuar.


8. Vetëm 7,3% janë përgjigjur **se punën e KGJRM e vlerësojnë si efektive**, ndërsa madje 84,6 % konsiderojnë se puna e KGJRM nuk është efektive, 8.1% e të anketuarve kanë dhënë përgjigje neutrale.




9. Në pyetjen **“A konsideroni se puna e KGJRM është transparente dhe e hapur?”**, një përqindje mjaft e lartë prej 90.2 % e avokatëve janë përgjigjur se puna e Këshillit nuk është transparente dhe e hapur, ndërkaq vetëm 6.6% janë të mendimit se megjithatë Këshilli punon në mënyrë transparente dhe të hapur. Në lartësi prej 3.3% të përgjigjeve avokatët kanë dhënë sqarime tjera.




10. Sa i përket pyetjes **“Sipas Jush, a thua Këshilli Gjyqësor në kuptimin e mirëfilltë të fjalës e siguron dhe garanton pavarësinë dhe mëvetësinë e pushtetit gjyqësor?”** 94,3% e të anketuarve janë përgjigjur me JO, 2.4% janë përgjigjur me PO dhe 3.3% kanë dhënë përgjigje tjera.



11. Gjithashtu, 84% e të anketuarve janë përgjigjur se mënyra dhe kriteri për zgjedhjen e anëtarëve të KGJRM, NUK **e garantojnë paanshmërinë dhe profesionalizmin e anëtarëve të zgjedhur**, ndërsa 7% konsiderojnë se mënyra dhe kriteret e zgjedhjes, megjithatë e garantojnë paanshmërinë dhe profesionalizmin e anëtarëve të zgjedhur, 9% e të anketuarve kanë dhënë përgjigje tjetër.



12. Sa i përket pyetjes **“A konsideroni se zgjedhja e gjyqtarëve nga ana e KGJRM është plotësisht objektive dhe se në bazë të tij zgjidhen gjyqtarë cilësor?”** 92% janë përgjigjur me JO, 4% janë përgjigjur me PO dhe 4% kanë dhënë përgjigje tjetër.




13. Në lidhje me pyetjen **“Çka mendoni se është e rëndësishme për avancimin e pavarësisë, profesionalizmit dhe transparencës së Këshillit Gjyqësor të RM?”**

Të gjitha përgjigjet ishin në drejtimin se zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të RM-së të cilët janë profesionistë, të paanshëm, si dhe në drejtim të mosndërhyrjes së partive politike në zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin Gjyqësor; “Të sigurohet pavarësi dhe mëvetësi e plotë financiare nga autoritetet e tjera të pushtetit.” Në shumicën e përgjigjeve theksohet se anëtarët e KGJRM duhet të jenë ekskluzivisht gjyqtarë dhe të mbahet llogari që ata të jenë gjyqtarë me përvojë shumëvjeçare të cilët janë dëshmuar ndër vite si gjyqtarë me integritet dhe pavarësi.


## ANALIZA E PYETËSORËVE TË PUBLIKUT TË GJERË

Instituti për të Drejtat e Njeriut përpiloi pyetësorë edhe për publikun e gjerë, në mënyrë që ta konstatoj perceptimin momental dhe njohuritë e publikut të gjerë lidhur me punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit për Përcaktimin e Fakteve. Pyetësorët e publikut të gjerë u publikuan në rrjetet sociale dhe u dërguan përmes postës elektronike dhe morëm përgjigje nga 184 qytetarë. Përgjigjet e pyetjeve janë pasqyruar në sqarimet si vijojnë:


### 1. A keni qenë të njoftuar deri më tani me punën e KGJRM?




**2. A jeni të njoftuar me kompetencat të cilat KGJRM i ka sipas ligjit?**



**3. A konsideroni se ky organ ka ndikim mbi cilësinë e punës së gjyqësorit në përgjithësi?**




**4. A keni marrë pjesë ndonjëherë në mbledhje të hapur të KGJRM?**




**4.1. Nëse po, kush është mendimi juaj për transparencën e debateve dhe të anëtarëve të KGJRM?**

Janë pranuar vetëm katër përgjigje se kanë marrë pjesë në mbledhje të hapur të Këshillit Gjyqësor, prej të cilave të gjithë janë përgjigjur se në mbledhjet në të cilat kanë marrë pjesë, debati nuk ka qenë i hapur dhe transparent.

**5. A jeni të njoftuar me punën e organit të sapo formuar "Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurave për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit"??**



4. **A keni paraqitur ndonjëherë parashtrësë deri te Këshilli Gjyqësor i RM ose deri te Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit pas marrjes së kompetencës?**



4.1. **Nëse po, atëherë a ishit të kënaqur me punën e KGJRM ose të Këshillit të Fakteve?** Të gjitha përgjigjet ishin se “assesi” nuk janë të kënaqur nga puna e KGJRM ose e Këshillit të Fakteve.

## FOKUS GRUPI

Për qëllimet e Projekti, përveç pyetësorëve të anketës dedikuar avokatëve edhe pyetësorëve dedikuar për publikun e gjerë, Instituti për të Drejtat e Njeriut organizoi diskutim në formën e fokus grupit, me qëllim që drejtpërsëdrejti të dëgjohen qëndrimet e qytetarëve për çështje kyç lidhur me sistemin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë. Pjesëmarrësit u zgjodhën duke mbajtur llogari për përfaqësimin e qytetarëve me shkallë të ndryshme të arsimit, të cilët, sipas profesionit nuk janë juristë dhe u përkasin bashkësive të ndryshme etnike.

Të anketuarit fillimisht u pyetën se a kanë besim në sistemin gjyqësor? Kësaj pyetje të gjithë iu përgjigjën se nuk kanë besim, ndërsa si shkak për këtë i theksuan vendimet të cilat miratohen nga ana e gjyqtarëve. Pastaj, pjesëmarrësit u pyetën se a janë të njoftuar me punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Fakteve. Nga përgjigjet mund të konstatohet se pjesëmarrësit kanë dëgjuar për Këshillin Gjyqësor, megjithatë jo edhe për Këshillin e Fakteve dhe çka punon ai.

Në pyetjen sa është e kuptueshme gjuha e gjyqtarëve, të anketuarit pajtohen se gjyqtarët nuk drejtohen me gjuhë e cila është e kuptueshme për publikun e gjerë, ndërkohë që nuk janë mjaftueshëm të kuptueshme as komunikatat të cilat rezultojnë nga kasta gjyqësore.

Përmes fokus grupit u konstatua se puna e Këshillit Gjyqësor nuk është aspak vizibile, ndërkaq pjesëmarrësit nuk ishin të njoftuar me punën e Këshillit të Fakteve. Perceptimi i vetëm i fituar nga ana e pjesëmarrësve është se nuk kanë besim në gjyqësorin dhe konsiderojnë se gjyqësori është i politizuar.

Rezultatet e fokus grupit pohojnë se qytetarët fare pak janë të njohur me punën e Këshillit Gjyqësor dhe me mundësitë e tyre (për parashtrësë dhe ankesa).

